



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM/KANCELARIJA GENERALNOG
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

Nr. i dokumentit 21.15.1-2008-08

**RAPORTI FINAL I AUDITIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE
TË MINISTRISË SË DREJTËSISË PËR VITIN E PËRFUNDUAR
ME 31 DHJETOR 2008**

Prishtinë, 27 Korrik 2009

Tabela e përmbajtjes

- I. Përmbledhje e përgjithshme
- II. Hyrje
- III. Gjendja e rekomandimeve nga vitet e kaluara
- IV. Fushëveprimi i auditimit
- V. Qasja e auditimit
- VI. Opinioni i auditimit
- VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

Shtojcat:

- I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit (ISSAI 400)
- II. Komentet e MD dhe përgjigjet e ZAP-it

Lista e shkurtesave

AP	Auditori i Përgjithshëm
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
DASHC	Departamenti i Administratës së Shërbimit Civil
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit Suprem
KM	Kabineti i Ministrit
LMFPP	Ligji Nr. 03/L-048 Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji Nr. 02/L-99 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Prokurimin Publik Kosovë nr. 2003/17
LVTH	Llogaria e Vetme e Thesarit
MD	Ministria e Drejtësisë
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
OP	Operatori Ekonomik
QP	Qendra e Paraburgimit
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
UA	Udhëzimi administrativ
UD	Ushtrues detyre
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZPZHML	Zyra e Personave të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore

I. Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Drejtësisë (MD) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008.

Auditimi jonë është kryer, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të hartuara, nga INTOSAI dhe ka përfshirë testet dhe procedurat që ne i kemi vlerësuar si të nevojshme, për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale. Ne dëshirojmë t'iu tërheqim vëmendjen në faktin që: Regjistri i Pasurive Jo financiare nuk është shpalosur në Pasqyrat Financiare (**ISSAI 400 Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes, shih aneksin**).

Të gjeturat kryesore gjatë auditimit janë si më poshtë:

1. Diferencat në mes të informatave të Thesarit me Pasqyra Financiare dhe informatave në lidhje me kodet ekonomike,
2. Regjistrimi i pasurive nuk është i kompletuar,
3. Procedurat e prokurimit nuk zbatohen në tërësi,
4. Kualiteti i kontrollit financiar është shumë i dobët dhe duhet të përmirësohet.

Rekomandimi ynë kryesor është që, Ministria duhet të krijojë një sistem efektiv të kontrollës së brendshme që siguron besueshmërinë dhe integritetin e informatave financiare dhe atyre operative.

II. Hyrje

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është sipas ligjit përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë.

Auditimi i Rregullsisë është definuar si verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e deklaratave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm;
- Për ndershmërinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative që mirren nga institucioni ose subjekti që i është nënshtruar auditimit; dhe

- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin;

Është përgjegjësi e Ministrisë së Drejtësisë (MD) të përgatisë Pasqyrat Financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP), për “Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”, në përputhje me Udhëzimin Administrativ 2008/13, dhe ato ti prezantoj me kohë.

III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara

Raporti ynë i auditimit të Pasqyrave Financiare për vitin 2007 kishte dhënë 8 rekomandime. Auditimi ynë i tanishëm ka vërejtur që MD ka zbatuar 1 rekomandim. Katër rekomandime janë zbatuar pjesërisht, ndërsa të tjerat janë në proces të adresimit.

Fushat më të rëndësishme për adresim të mëtejshëm janë:

- (a) Zhvillimi i procedurave të prokurimit në pajtim me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme.
- (b) Menaxhmenti ti përgjigjet rekomandimeve të dhëna nga ana e auditorit të brendshëm dhe hartimin e një plani të veprimit.
- (c) Përmirësimi i menaxhimit të pasurive në pajtueshmëri me Rregulloret e aplikueshme.
- (d) Mirëmbajtja më e mirë e dosjeve të personelit, në pajtim me Rregulloret e aplikueshme.

Dështimi i menaxhmentit të MD-së në adresimin e plotë të rekomandimeve tona ka dërguar tek ekzistimi i problemeve të njëjta sikur edhe nga viti i kaluar . Mungesa e masave të vendosura nga menaxherët përgjegjës mbi rekomandimet e auditimit janë një shqetësim.

IV. Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim i MD ka të bëjë me pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2008.

Objektivi primar i këtij auditimi ishte që t’i mundësohet ZAP të shpreh opinionin e saj nëse pasqyrat financiare të MD, japin një pasqyrë të vërtet dhe të drejtë dhe nëse regjistrat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me Ligjet dhe rregulloret aplikative.

V. Qasja e auditimit

Auditimi ynë është planifikuar dhe realizuar gjatë periudhës prej 18 Mars 2008 deri më 23 Maj 2009, në bazë të Standardeve të Auditimit të INTOSAI-it.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave tona, ne:

1. Kemi rishikuar pasqyrat financiare të MD në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2008,
2. Kemi përcaktuar nëse pasqyrat financiare të MD janë përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”,

3. Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
4. Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
5. Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit, 5% për paqartësitë dhe 3% për gabimet, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
6. Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;
7. Kemi vlerësuar pavarësinë dhe cilësinë e Njësisë së Auditimit të Brendshëm në MD, për të përcaktuar nëse mund të mbështetemi në punën e tyre për qëllimet e auditimit tonë.

Të gjeturat dhe konkluzionet tona të auditimit bazohen në dokumentacionin, informatat dhe shpjegimet të cilat na janë dhënë gjatë punës sonë të auditimit.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat financiare të MD-së, standardet ndërkombëtare përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit i cili mund të jepet. Opinionin i auditimit mund të jetë i pakualifikuar, i kualifikuar, i kundërt ose mund të jetë edhe mohim i opinionit (Cf. Aneksi 1 ISSAI 400).

VI. Opinioni i auditimit

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale. Ne dëshirojmë t'iu tërheqim vëmendjen në faktin që: Regjistri i Pasurive Jo financiare nuk është shpalosur në Pasqyrat Financiare (ISSAI 400 *Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes, shih aneksin*).

VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

1. Rezultati Financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon se: shpenzimet e përgjithshme aktuale për vitin 2008 ishin 15,799,077€. Prej tyre 15,344,603€ janë të realizuara, ndërsa 474,474€ ishin obligime të bartura në vitin 2009.

Krahasuar me buxhetin, Ministria kishte shpenzuar rreth 81.6 % të buxhetit të planifikuar dhe në fund të vitit 2008 kishte një suficit prej 3,457,260€.

Të hyrat nga provizionet e të burgosurve për vitin 2008 sipas Pasqyrave Financiare ishin 757,052€.

Konkluzioni

Sipas vlerësimit tonë Ministria kishte shpenzuar buxhetin për vitin 2008 në kuadër të limiteve të përcaktuara nga Kuvendi me rastin e aprovimit të Buxhetit për vitin 2008. Megjithatë, buxheti i pa shpenzuar prej 19.4% është një sinjal se MD duhet të përmirësoj planifikimin buxhetor.

2. Pasqyrat financiare

Pasqyrat Financiare për vitin 2008, janë përgatitur kryesisht duke u bazuar në shënimet e Thesarit e jo në bazë të regjistrave të saj kontabël. Ekzistojnë diferenca në mes shënimeve të Thesarit me Pasqyra Financiare dhe regjistrave kontabël, të MD-së. Sqarimi për këtë është se nuk janë përdorur kode të njëjta ekonomike në mënyrë konsekuente.

- Diferenca totale është në vlerë prej 950,422 €, të dhënat të Thesarit ndaj Pasqyrave Financiare dallojnë në vlerë prej 96,657€
- Të hyrat bazuar në shënimet të thesarit janë 767,928€, ndërsa në Pasqyra Financiare janë paraqitur në vlerë prej 757,052€. Diferenca është në vlerë prej 10,930€.
- Pasuritë nuk janë të paraqitura në Pasqyrat Financiare.

Konkluzioni

Ne konkludojmë që edhe pse jo në aspektin material, mënyra se si janë përgatitur Pasqyrat Financiare, në tërësi nuk kanë shpalosur situatën aktuale si dhe kanë zvogëluar saktësinë dhe besueshmërinë.

Rekomandimi 1

Rekomandojmë Ministren e Drejtësisë-së që të siguroj:

- Shënimet e kontabilitetit do të përgatiten dhe Pasqyrat Financiare do të bazohen në shënimet kontabël të Ministrisë.
- Që Pasqyrat Financiare në të ardhmen do të përfshijnë të gjitha të ardhurat dhe të gjitha pasuritë do të shpalosen.

3. Realizimi i Buxhetit

3.1 Të Hyrat

Depozitat për të burgosurit mbahen në llogari të Thesarit dhe menaxhohen nga MD. Ato nuk definojnë si para publike. Këto para i takojnë të burgosurve dhe mund të shpenzohen vetëm me kërkesë të burgosurve. Depozitat sipas raportit bankar: të bartura nga viti paraprak ishin 145,598€, të hyrat e këtij viti janë 926,038€. Gjendja e mbetur e depozitave me 31.12.2008 është 163,873€.

Të hyrat nga granti i jashtëm në Ministrinë e Drejtësisë për vitin 2008 kanë qenë 104,185€.

3.2 Pagat dhe Mëditjet

Buxheti për kategorinë paga dhe mëditje për vitin 2008 ka qenë 6,534,512€, derisa shpenzimet aktuale për paga ishin 5,994,666€. Suficiti për vitin 2008 nga kategoria paga dhe mëditje është 539,846€ .

Ne kemi përzgjedhur për testim 37 dosje të personelit dhe gjetjet tona janë si në vijim:

- Në shumicën e dosjeve të personelit mungon përshkrimi i detyrave.

- Në 4 dosje nuk gjendet kopja e nevojshme e dokumentit të identifikimit.
- Në shtatë raste mungon vlerësimi në fund të vitit.
- Në një dosje mungon dëshmia për përgatitjen shkollore.
- Në një kontratë pune ekziston një mos përputhje në lidhje me Aprovimin e vendimit.

Konkluzioni

Nga mostra e marrë, konstatojmë se dosjet e personelit nuk janë mbajtur ashtu siç kërkohet me Rregulloret e aplikueshme.

Rekomandimi 2

Rekomandojmë Ministren e Drejtësisë që të siguroj:

- Menaxhimi i Personelit të bazohet në Rregullat e aplikueshme.

3.3 Mallrat dhe Shërbimet

Të gjeturat

Ne kemi vërejtur se janë tejkaluar limitet e lejuara për shpenzime të telefonave fiks dhe mobil të cilat limite janë të rregulluara me Udhëzimin Administrativ nr. 04/2008 për përdorimin e telefonave. Në disa raste nuk janë nënshkruar zyrtarët për pranimin e mbushjeve të telefonave janë nënshkruar vetëm nga udhëheqësit e regjioneve që kane pranuar mbushjet për stafin e tyre e jo edhe nga zyrtarët që kane pranuar mbushje. Në zyrën e ministrit nuk janë nënshkruar personat që kanë pranuar nga 70€ në muaj mbushje.

Ekzaminimi i shpenzimeve të telefonisë fikse për muajt: Janar, Mars, Prill, Qershor, dhe Tetor rezultojë me tejkalim të shpenzimeve.

Në tabelën Nr 1 janë të paraqitura 15 raste, ku shpenzimet aktuale i tejkalojnë shpenzimet e lejuara sipas udhëzimit administrativ Nr. 04/2008.

Tabela Nr 1 Shpenzimet e tejkaluara të telefonisë fikse.

Periudha	Pozita	Nr i tel..fiks	Shpenzimet e lejuara €	Shpenzimet e ndodhura €	Ndryshimi €
janar	OMF.hetues për komunitete-2 veta	544 850	2x10	121	101
Mars	Zyrtare për informim publik	213 097	20	105	85
Mars	Menaxher i projektit	213 105	15	56	41
Mars	Asistente administrative e-KM	213 121	20	65	45
Mars	Këshilltare i protokollit	213 211	50	83	33
Mars	Asistente e ministrit	213 389	20	64	44
prill	Dep.Mbrojtje e ndihmë viktimës	243 253	20	100	80
prill	Dep.Mbrojtje e ndihmë viktimës	243 245	2x10	97	77
prill	Dep.Mbrojtje e ndihmë viktimës	246 059	20	77	57
qershor	Asistent ekzekutiv i sekretarit	213 092	20	109	89
qershor	Zyrtare për informim publik	213 097	20	105	85
qershor	Asistente ekzekutive e KM	213 121	20	61	41
qershor	Bashkëpunëtorë i projektit	213 105	15	58	43
tetor	Asistent i prokurimi	213 879	15	80	65
tetor	Asistent i prokurimit	213 878	15	61	46
Totali			310	1242	932

Konkluzioni

Mospërfillja e kufizimeve të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ 04/2008 ka rezultuar në kosto më të lartë se tarifat e lejuara mujore për përdorimin e telefonave fiks. Nga tabela më lart shihet, se vetëm 15 përdorues të telefonave zyrtar për katër muaj kanë tejkaluar limitin e lejuar prej €932.

Rekomandimi 3

Rekomandojmë Ministren e MD-së që të siguroj :

- Implementimin e plotë të Udhëzimit Administrativ 04/2008.
- Masa të menjëhershme për monitorimin e shpenzimeve të telefonit për të siguruar respektimin e limiteve të lejuara, dhe marrjen e masave për rikthimin e shumave të mbi shpenzuara. Për t'u arritur ky objektivi do të ishte i nevojshëm angazhimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm të MD-së.

3.4 Prokurimi

Gjatë vitit 2008 MD ka kryer 142 aktivitete prokurimi në vlerë totale prej 3,233,051€. Kemi zgjedhur mostrën prej 27 aktiviteteve prokurimi, në vlerë prej 962,752€. Nga kjo mostër kemi testuar 16 aktivitete për mallra dhe shërbime në vlerë prej 525,308€ dhe për investime kapitale 11 aktivitete në vlerë prej 437,444€.

Ne kemi vërejtur shkelje në disa aktivitete të prokurimit (nuk janë aplikuar procedurat e prokurimit në përputhje me LPP nr. 02/L-99).

Të gjeturat e paraqitura më poshtë pasqyrojnë:

Të gjeturat

1. Nuk aplikohen gjoba me rastin e vonesave të mallrave si p.sh.: vonesa deri në 130 ditë kalendarike për disa artikuj të *Furnizimit me material shpenzues mjekësor për ZPZHML* në vlerë prej 9,895€.
2. *Furnizimi me pajisje dhe material shpenzues mjekësor si dhe servisimi i aparateve mjekësore të Lot 2 dhe 5*
 - kontrata nuk nënshkruhet sipas çmimit të komisionit vlerësues, por mbi vlerësohet për Lot-in 2 nga 49,955€ në 54,255€ dhe për Lot-in 5 nga 1,215€ në 1,681€ (diferenca 4,300€ dhe 366€).
 - nuk gjinden dëshmitë për aprovimin e shkurtimit të afatit kohor.
3. Raporti i pranimit të *Furnizimeve me pajisje trafiku* pa datë dhe i pa nënshkruar nga zyrtari autorizues për pagese në vlerës 2,496€.
4. *Furnizimet me llap-top për KM*
 - pranimi i mallit në vlerën prej 7,344€ është bërë para hapjes së ofertave gjegjësisht para nënshkrimit të kontratës.
 - Mungojnë deklaratat nën betim të anëtarëve të komisionit vlerësues
5. Kompania fituese e tenderit “*Furnizim me tonerë*” për MD.
 - Raporti teknik mbi pranimin e mallit „*Furnizim me tonerë*” në vlerë prej 2,910€ nuk ka kurrfarë date se kur është bërë.
6. Te *Furnizimi me bileta aeroplani*,
 - mungojnë kërkesa e udhëtimit dhe dëshmitë e udhëtimit.
 - Nga dëshmitë e ofruara për *Furnizim me bileta aeroplani* dëshmitë nuk vërtetojnë se ka zbritje sipas *marrëveshjes afatgjatë më 30/2008*.
7. *Furnizimi me material shpenzues për zyre – Lot 1* fatura prej 7,998€ nuk ka numër dhe është e panënshkruar nga pranuesi i faturës.
8. *Furnizimin me material elektrik, sanitar dhe moleri Lot 2* e nënshkruar me 06.12.2008 vërejtëm këto parregullsi, siç janë:
 - Mungon kërkesa e inicimit të aktivitetit të prokurimit te *Furnizimi me material elektrik, sanitari dhe moleri Loto 2*
 - Fletë dërgesa para nënshkrimit të kontratës.
 - Mungon sigurimi i tenderit 3%.
 - Sigurimi i ekzekutimit 6 ditë pas nënshkrimit të kontratës.Aneks kontrata nr.1 e nënshkruar pa kërkesë dhe pa aprovim.
9. *Furnizimi me material elektrik, sanitar dhe moleri-Lot 1* në vlere prej 51,215€ Sasia e furnizimit është më e madhe se sa sasia e kërkuar në specifikimin teknik.

10. *Furnizim me pajisje mjekësore laboratorike për ZPZHML në vlere prej 51,373€ , deklaratat nën betim të nënshkruara nga anëtarët e komisioneve, nuk janë në dosjen e Audituar.*
11. *Furnizim me veshmbathje raporti i pranimit të mallit është nënshkruar nga zyrtari i pranimit i cili njëkohësisht është edhe në komision të pranimit teknik të mallit, me 16.12.2008, ndërsa pranimi teknik i mallit nga komisioni është bërë me datë të fletë dërgesës me 17.12.2008. Edhe formulari i aprovimit të pagesës thuhet se bëhet në bazë të raportit të pranimit.*
12. *Ri-tenderimi për marrjen me qira të hapësirave për zyre të departamenteve të MD, në Prizren*
 - nuk është respektuar afati i shkurtimit prej 15 ditëve.
 - Komisioni vlerësues nuk ka qenë real në vlerësimin e ofertave se janë apo jo të përgjegjshme, prandaj tri oferta të përgjegjshme nuk kanë qenë, sepse dy ofertues nuk kanë dorëzuar ofertat e kompletuara me dokumentacionin e kërkuar në dosjen e tenderit (lejet e ndërtimit).
 - Kontrata është nënshkruar për hapësirën prej $1,300 \text{ m}^2 \times 6,3 = 8,190\text{€}$, ndërsa sipas përshkrimit teknik të objektit ka një hapësirë prej $944,3 \text{ m}^2 \times 6,3 = 5,949\text{€}$, d.m.th. paguhet më tepër $355.7 \text{ m}^2 \times 6,3 = 2,240\text{€/muaj}$, gjegjësisht $2,240.91 \times 12 = 26,890\text{€}$.
 - Nuk është shpërblyer me kontratë operatori në total më i lirë prej 7,650€/muaj për hapësirë prej 900 m^2 , ndërsa vlera e përlogaritur është bërë për hapësirë prej $900 - 1000 \text{ m}^2$ në vlerë prej 8,000€.

Konkluzioni

Mosrespektimi i LPP tregon se Ministria e Drejtësisë ka një kontrollë të dobët dhe e vënë në rrezik Menaxhimin e dobët të Ministrisë.

Rekomandimi 4

Rekomandojmë Ministrin e MD-së që të siguroj :

- Aplikimin e procedurave të prokurimit në kuadër të Ministrisë në përputhje me LPP.

3.5 Investimet Kapitale

Buxheti për kategorinë e Investimeve Kapitale për vitin 2008 ishte 5,572,807€, ndërsa shpenzimet ishin në vlerë prej 4,345,171€ që rezulton me një suficit në shumën prej 1,227,636€.

Të gjeturat

- Shuma e mjeteve në vlerë prej 17,005€ për *Ndërtimin e shtallës në Burgun e Dubravës* është zotuar një pjesë me vonesë, me datë 16.06.08 pas fillimit të procedurave të prokurimit.
- Në kontratë nuk është qartësuar forma e pagesës, e tërë shuma është e ndarë në tri pjesë dhe nuk precizohet koha dhe shuma për pagesë të *Ndërtimit të shtallës së Burgut të Dubravës*.

- Në pjesën III.neni 2.2 të dosjes së tenderit kërkohet depozitimi i sigurisë së ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës me vlefshmëri prej 12 muaj si p.sh. te: *Ndërtimin i shtallës së Burgut të Dubravës, Ndërrimi i gypave nëntokësor të ngrohjes dhe radiatorëve në QK Lipjan, Ndërtimi i objektit për pritjen e vizitorëve në Burgun e Dubravës.*
- Për kryerjen e punëve me vonesë nuk janë aplikuar gjobat.
- Nga tre OE, dy prej tyre nuk përmbushur kriteret e kërkuara me dosjen e tenderit.
- *Furnizim dhe monitorim i gjeneratorit për SHKK* në vlerë prej 29,993€ në dosje të tenderit mungon dëshmia për aprovimin e kërkesës për iniciimin e procedurave të përshpejtuara të prokurimit.
- *Në kontratën „Renovimi i brendshëm në QP Pejë* në vlerë prej 9,932€ mungojnë deklaratat nën betim për anëtarët e komisionit të vlerësimit,aprovimi për lejimin e procedurave të prokurimit nuk është bërë nga personi autorizues (sekretari permanent).
- Janë lidhur 6 kontrata përmes procedurave të kuotimit të çmimeve për renovime të objekteve të MD-së, të cilat kanë mundur të kryhen me një procedurë të hapur të tenderit.
- Te kontrata *Renovimi i brendshëm në QP Gjilan* në vlerë prej 9,882€ . Ka bërë ndërrimin e kodit të projektit.

Konkluzioni

Shmangja nga procedurat e prokurimit, krijohen rrethana të keq përdorimit të parasë publike, kualitetit të dobët të ndërtimit dhe konflikte interesash.

Rekomandimi 5

Rekomandojmë Ministren e Drejtësisë që të siguroj :

- Të siguroi që menaxhimi financiar i investimeve kapitale të forcohet në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi të aplikueshme.
- Forcimin e kontrolleve të brendshme të investimeve kapitale.
- Staf i me përgjegjësi të deleguara në këtë fushë të avancohet sa i përket kërkesave ligjore dhe obligimeve të kontrolleve të brendshme të Ministrisë.

3.6 Paraja e imët

Ne kemi zgjedhë një mostër që ka përfshirë pagesat e Parave të Imëta që janë realizuar në këto njësi : Zyra e Ministres, PPK Prizren, Sektori i Integritetit Gjyqësor, Shërbimi Korrektues i Kosovës (Burgu i Dubravës, Qendra e Paraburgimit Pejë).

Të gjeturat

Në këtë fushë kemi vërejtur shkelje të LMFPP dhe Rregullës Financiare-02.

- Nuk është aplikuar mbajtja e ditarit të arkës nga zyrtari i parave të imëta .
- Është vërejtur ndarje e faturave në pjesë për shpenzimet në vlerë mbi 100€.

Paratë e imëta në masë të ndjeshme janë përdorur për pagesat:

- Për autolarje të veturave të ministrisë si dhe shpenzime reprezentacioni.
- Servisim, vaj, filtër për gjenerator.
- Pagesa e reprezentacionit në vlera të njëjta mujore¹.
- Mirëmbajtje të automjeteve

Edhe pse Ministria e Drejtësisë ka të kontraktuar punët dhe shërbimet për servisim dhe autolarje të veturave, si dhe servisim të gjeneratorëve, megjithatë këto shërbime shpesh janë bërë përmes Parasë së Imët.

Konkluzioni:

Janë bërë shpenzime nga paraja e imët për shpenzimet të cilat mund të planifikohen gjegjësisht për të cilat është dashur të mbulohen nga kontratat ekzistuese.

Shpenzimi i Parasë së Imët për furnizime dhe shërbime të cilat MD i ka veç të kontraktuar, mund të ngris dyshime në keqpërdorimin e parasë së imët. Për më tepër, ndarja e faturave në pjesë për furnizim nga të njëjtit operator dhe periudhë të njëjtë është në kundërshtim me rregullat e përdorimit të Parasë së imët.

Rekomandimi 6

Rekomandojmë Ministren e Drejtësisë që të siguroj :

- Paratë e imëta duhet të kenë një përkujdesje në atë mënyrë që mos të shfrytëzohen për ato furnizime apo shërbime të cilat mund të jenë të parashikueshme,
- Shpenzimet për servisim dhe mirëmbajtje të automjeteve dhe gjeneratorëve, duhet të planifikohen përmes linjave buxhetore të rregullta,
- Ndarja e faturave për shpenzimet mbi vlerën 100€ duhet të ndërpritet, dhe të veprohet në bazë të rregullave për shfrytëzimin e Parasë së Imët,
- Të lidhen kontrata për të gjitha ato shërbimet apo furnizimet të cilat mund të planifikohen.

3.7 Menaxhimi i pasurive

Në bazë LMFPP, Organizatat Buxhetore janë të obliguara të regjistrojnë të gjitha transaksionet dhe të mbajnë Regjistra Kontabël në përputhje me Udhëzimin Administrativ, nr.2005/11 mbi regjistrimin e pasurive qeveritare, të lëshuar nga Ministria për Ekonomi dhe Financa.

Organizata buxhetore duhet ti regjistrojë informatat e pasurive në Regjistrin e pasurive dhe Regjistrin kontabël pasi që pasuritë të jenë klasifikuar dhe të jetë kryer vlerësimi nga ana e Komisionit për vlerësim.

Të gjeturat

- Në bazë të vendimit ZSP-Nr.11/3 datë 10.03.2009, është formuar komisioni për vlerësimin e pasurive, i cili nuk ka vepruar sipas vendimit, gjegjësisht nuk ka bërë vlerësimin dhe regjistrimin e pasurive të MD për vitin 2008.
- Regjistri kontabël (sistemi i Thesarit) që paraqet pasuritë me vlerë mbi 1,000€ tregon një vlerë totale prej 4,666,600€, e cila njëherit është e prezantuar si raport i

pasurive të përgjithshme në Pasqyrat Financiare për vitin 2008.

- Nga sektori i logjistikës ne kemi siguruar listën e pasurisë që është pranuar në vitin 2008 në vlerë prej 1,230,963€, por e regjistruar në sistem (Free Balance) në vitin 2009. Nga kjo rrjedhë se rezultati përfundimtar i pasurive në sistem është :
$$4,666,600€ + 1,230,963€ = 5,897,563€.$$
- Ndërkaq, Pasqyrat financiare në shënimin 15 (Pranimet Kapitale) dhe shënimi 27 (përmbledhja e aseteve jofinanciare) nuk paraqet asnjë vlerë të aseteve.
- Është vërejtur mungesë e politikave dhe procedurave të detajuara dhe adekuate në lidhje me njohjen dhe shlyerjen e pasurisë, matjeve, kostos së ardhshme dhe zhvlerësimit .
- Një numër i konsiderueshëm i pajisjeve të reja (fotokopje, kompjuter, etj) qëndrojnë në depo të pashfrytëzuara, dhe nuk bëhet shpërndarja apo përdorimi i tyre .

Konkluzioni:

Te menaxhimi i pasurive mungon një sistem i mirëfilltë i kontrollit. Kjo ndikon në paraqitjen e sakët në Pasqyra Financiare dhe keqpërdorimin e pasurive.

Rekomandimi 7

Rekomandojmë Ministren e Drejtësisë që të siguroj :

- MD duhet të ndërmerr veprime për të siguruar që proceset e menaxhimit të pasurive të janë në pajtim të plotë me kërkesat e Udhëzimit Administrativ, nr. 2005/11 i cili i ofron menaxhmentit udhëzime mbi menaxhimin dhe regjistrimin e pasurisë qeveritare si dhe detajet në lidhje me heqjen e pasurisë nga përdorimi, matjen, koston dhe zhvlerësimin ose shlyerjen e pasurisë .

3.8 Menaxhimi i Automjeteve

Ministria e Drejtësisë gjatë vitit 2008 mban në evidencë 183 automjete të ndryshme dhe një traktor me rimorkio. Prej tyre 144 automjete janë në gjendje të rregullt të cilat kanë shpenzuar karburante. Gjatë këtij viti janë blerë 3 automjete.

Mostra për muajin Nëntor 2008 ka përfshirë 16 automjete:

Të gjeturat:

- Në disa dosje mungon autorizimi për shfrytëzimin e automjetit si dhe fletudhëtimi zyrtar. Aty ku ekziston autorizimi dhe fletudhëtimi zyrtar, mungojnë: shënimi i destinimit konform kilometrave të kaluara, mos arseyshmëria e kërkesës.
- Asnjë vozitës nuk është i ngarkuar me ndonjë automjet. Ato voziten sipas nevojave të rastit.
- Ka automjete pa „Fletë udhëtimin për automjetin Zyrtar”.
- Ka mungesa të „Kërkesës për përdorim të përkohshëm të automjeteve zyrtare të MD”.
- Ka kartela të automjeteve në të cilat nuk janë evidentuar kilometrat dhe shpenzimet e karburanteve .
- Ka mos përputhje të vogla të karburanteve në mes kartelevë dhe „Fletë udhëtim për automjetin zyrtar”.

- Tejkallim i shpenzimeve të karburanteve,
- Mungesë e normativit për harxhime të automjeteve.
- Mungon raporti i vlerësimit të komisionit për automjetet që janë donacion.
- Mungon raporti i vlerësimit të komisionit për tjetërsimin e automjeteve (jashtë përdorimit).
- Në disa fletë dërgesa të furnizimit me karburante për automjete e veçanërisht automjeteve të prokurorive nuk shënohet numri i kilometrave në kolonën e paraparë për shënim.

Konkluzioni

Shfrytëzimi pa ‘Kërkesë për përdorim të përkohshëm të veturave zyrtare’ dhe mungesa e ‘Fletë udhëtimit për automjetin zyrtar’ është në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2008 dhe rrit rrezikun e shfrytëzimit të automjeteve për qëllime jo zyrtare. Në mungesë të menaxhimit të automjeteve është e mundshme që shpenzimet e karburanteve të mos jenë duke u kontrolluar në mënyrë efektive.

Mungesa e normativit për harxhime të automjeteve krijon mundësinë e keqpërdorimit të sasisë së karburantit.

Rekomandimi 8

Rekomandojmë Ministren e Drejtësisë që të siguroj:

- Përdorimi dhe menaxhimi i automjeteve duhet të bëhet sipas Udhëzimit Administrativ nr. 03/2008
- Dosja për përdorim të automjeteve duhet të përmbaj librin mbi përcaktimin e limiteve të shpenzimeve të karburanteve.

3.9 Menaxhimi i karburanteve

Ministria e Drejtësisë furnizohet me karburante të lëngëta dhe të gazta nga „Standard Benz” me një të drejtë të vazhdimt të kontratës së mëparshme me çmim të premiumit: për: naftë = +0.065€ ; benzinë = +0.045€ dhe gas propan-butan = 0.097€.

MD karburantet i përdor për:	- <i>automjete</i>	=	206,315€
	- <i>derivate për nxemje dhe gjenerator</i>	=	1,086,991€
	- <i>propan-butan gaz</i>	=	52,888€
T O T A L –i karburanteve të paguara gjatë vitit 2008		=	1,346,196€

Të gjeturat:

Si rezultat i testimeve tona, kemi përmbledhur këto parregullsi:

- Për zyrtaret e autorizuar, nuk ekziston ndonjë politike e MD për caktimin e limitit për shfrytëzimin e të drejtës për naftë dhe derivate të saja.
- Janë pranuar sasi të karburanteve pa ndonjë komision apo raport teknik të pranimit, p.sh..fak..nr..0700262, flete dërgesat nr. 012547, 010329, 010275, 010345, 010315 etj.
- Nuk ka Raport të pranimit gjatë furnizimit me karburante për gjenerator apo nxehje në disa dosje të shpenzimeve për Prokurori.

- Nuk ka raporte të mirëfillta financiare në zyrën e Financave dhe në zyrën e transportit, gjegjësisht nuk ka zyrtar për mbajtjen e shënimeve të shpenzimeve të karburanteve për ngrohje dhe gjenerator.

Konkluzioni

Mungesa e një politike apo rregullore të brendshme e cila do të rregullonte çështjen e të drejtës për shfrytëzimin e naftës dhe derivateve, krijon mundësi për rrezik që të bëhet keqpërdorimi i derivateve.

Ne konkludojmë se nëpër të gjithë hapat e procesit gjatë shpenzimeve të karburanteve janë vërejtur dobësi të dukshme të kontrollit të brendshëm të cilat menaxhmenti duhet t'i ketë në konsiderim.. Në funksionim ka disa kontrole jo-adekuate të cilave nuk mund të ju besohet. Për shkak të mungesës së kontrolleve dhe arkivimit adekuat të dokumentacionit mbi shfrytëzimin dhe shpenzimin e karburanteve të automjeteve si dhe mungesës së raportit të pranimit të karburanteve për gjenerator se procesi i shpenzimeve të karburanteve është në përputhshmëri me rregulloret në fuqi.

Rekomandimi 9

Rekomandojmë Ministren e Drejtësisë që të siguroj

- Të bëhet menaxhimi i karburanteve në bazë të UA nr. 03/2008.

4. Auditimi i Brendshëm

Auditimi i brendshëm është segmenti i rëndësishëm i menaxhimit sipas së cilit organizata e ruan integritetin, efikasitetin e efektivitetin e sistemit financiar dhe të sistemeve të tjera të menaxhmentit të kontrolleve. Roli kryesor i Njësisë së Auditimit të brendshëm është ofrimi i sigurisë për menaxhmentin që sistemi i kontrollit të brendshëm funksionon siç është synuar.

Njësia e Auditimit të brendshëm ka një staf prej 2 personave dhe kishte përgatitur planin vjetor të punës për vitin 2008.

Njësia e Auditimit të Brendshëm e MD, gjatë vitit 2008 ka kryer 8 auditime në këto fusha: Planifikimin e buxhetit, fushën e prokurimit, kontratat afatgjate, parat private të burgosurve, shpenzimet e karburanteve dhe paraja e imët, shpenzimet e barnave,

shpenzimet e ushqimit dhe menaxhimit të pasurisë. Megjithatë ato fokusohen në fushat kryesore të shpenzimeve, të cilat paraqesin rreziqet kryesore në këtë Ministri.

Raporte theksojnë mangësitë e menaxhimit financiar në MD.

ZAP ka shikuar një përzgjedhje të raporteve të Auditimit dhe vlerëson se këto raporte janë të strukturuar mirë dhe identifikojnë të gjetura të rëndësishme në bazë të cilave adresohen 56 rekomandime: 32 rekomandime janë zbatuar, 14 rekomandime pjesërisht janë zbatuar ndërsa 10 rekomandime nuk janë zbatuar.

Konkluzioni

Ne kemi konstatuar se Auditimi i brendshëm është përqendruar në fushat me rrezikshmëri të lartë dhe kjo i është adresuar menaxhmentit të lartë. Mirëpo ka pak prova në lidhje me implementimin e këtyre rekomandimeve.

Rekomandimi 10

Rekomandojmë Ministren e Drejtësisë që të siguroj :

- Menaxhmenti duhet t'u japë përgjigje me shkrim rekomandimeve të auditorit të brendshëm dhe të hartojë një plan të detajuar për zbatimin e rekomandimeve.
- Njësia e Auditimit të brendshëm duhet të nxjerrë raport vjetor ku do të krahasohej puna e kryer kundrejt punës së planifikuar. Ky raport duhet po ashtu të evidentojë ecurinë në zbatimin e tërësishëm të rekomandimeve e sidomos atyre që kanë ndikim material në PF.

Shtojca 1

Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit të zbatuara nga ana e ZAP në Raportet Vjetore të Auditimit për vitin 2009 (e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është në format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një opinion i pakualifikuar jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistence (të qëndrueshme);
- (b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- (c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar; i
- (d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. Theksi i çështjeve. Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si ;nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- (a) ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit
- (b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- (c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. Opinioni i Kualifikuar. Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i

kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. Opinioni i Kundërt. Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinion i kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinion i tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. Mohimi i Opinionit. Aty ku Auditori nuk mund jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksione të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinion i tillë të kundërt a bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ILA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikua

Shtojca 2. Komentet e MD-ës dhe përgjigjet e ZAP-it

Komentet e Ministrisë	Përgjigja e ZAP-it
<p>Komenti 1 Pasqyrat Financiare</p> <p>Pasqyrat Financiare janë përgatitur sipas shënimeve të kontabilitetit të mbajtura në organizatën buxhetore sipas LMFPP nr. 03/L-048.</p> <p>Ministria e Drejtësisë ka trashëguar nga ish UNMIK-u, përpos Programeve dhe Përgjegjësi që i përketin asaj edhe pesë (5) Programe tjera që ishin përgjegjësi e ish Departamentit të Drejtësisë -UNMIK-ut KO 309 dhe 330) , që pas mbarimit të mandatit të tyre iu ofron mbështetje administrative.</p> <p>Në bazën e të dhënave për kontabël, përpos për OB 215 MD , janë mbajtur edhe për dy OB, 309 DD dhe 330 KPD , në fillim të vitit sistemi i të dhënave ka pasur pengesa, andaj gjatë paraqitjes së Pasqyrave Financiare për vitin fiskal 2008, edhe pse me MFE-Thesari janë barazuar të gjitha shpenzimet dhe transaksionet financiare, dallimet në kode ekonomike kanë mbetur si pasojë e mos funksionimit të këtij sistemi.</p> <p>Në kohën e auditimit , është vërejtur ndryshimi në kode ekonomike dhe i kemi rishikuar të gjitha regjistrimet, të cilat janë harmonizuar me kode ekonomike të Thesarit .</p> <p>Ndryshimi në kode ekonomike është pasojë e tri OB-ve ekzistuese dhe fazës së transicionit të kompetencave nga ish DD në MD , dhe mbetjen e pa definuar të disa kompetencave dhe Programeve .</p> <p>Në takimin përmbyllës me ekipin e auditorëve, edhe pse i kemi paraqitur gojarisht harmonizimet e dallimeve, si pasojë e mos funksionimit të bazës së të dhënave, nuk kemi mundur ti paraqesim. Pas marrjes së draft Raportit , është rregulluar Baza e të dhënave dhe Ju paraqesim regjistrimet kontabël të harmonizuara me regjistrimet në Thesar (e gjeni të bashkangjitur në formë elektronike dhe të shkruar në letër).</p> <p>Sa i përket ndryshimit të hyrave - depozitave të burgosurve (para private), të cilat menaxhohen nga ekipi i veçantë në Shërbimin Korrektues të Republikës së Kosovës, sipas Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të MFE dhe MD, sipas opinionit Tuaj me Raportin e Auditimit të PF të vitit</p>	<p>MD në komentet e veta nuk mohon faktet e konstatuara nga auditori por vetëm sqaron arsyet e ndodhjes. Në mungesë të dëshmive, ne vlerësojmë se sqarimet e MD-ës në komentet e veta nuk mundë të shërbejnë si bazë për të ndryshuar të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit.</p> <p>Të gjeturat dhe rekomandimet qëndrojnë.</p>
<p>Komenti 2 Mallra dhe Shërbime Shpenzimet e Telefonit në MD</p> <p>Dallimi i Shpenzimeve për telefona fiks dhe mobil është pasojë e njëjtë me dallimet e regjistrimeve kontabël të sipërshënuara për PF. Në këto shpenzime janë përfshirë edhe shpenzimet e telefonit nga paratë e të burgosurve.</p> <p>2.1 Tejkalimi shpenzimeve të telefonit fiks për disa zyrtar , ka ndodhur për këtë arsye:</p> <p>a) Asistentja e ministres, zëvendës ministrit dhe sekretarit permanent, mban lidhjen telefonike dhe bartë</p>	<p>2.1. Ne jemi bazuar ne UA.Nr. 04/2008</p> <p>MD në komentet e veta nuk mohon faktet e konstatuara nga auditori por vetëm sqaron arsyet e ndodhjes. E kuptojmë natyrën e punës së tyre, por nuk e keni të rregulluar me ndonjë rregullore të brendshme apo</p>

<p>thirrjet për zyrtarët e lartë të MD-së</p> <p>b) Për nr. tel. 038/243-253, 038 246 059 dhe 038/243 254 të cilët përdoren nga stafi i SHPS-së në Shtëpinë e Përkohshme të Sigurt, i cili staf arrin numrin total prej 9 (nëntë) vetave dhe përdoret 24 orë pa ndërprerë. Për kontakt me Familjet e viktimave të trafikut njerëzor, dhunës në familje, kontakteve me Gjykatën, Policin, OSCE, Qendrën për punë Sociale, OJQ të ndryshme, IOM-in, Shkollat, spitalet, ordinancat e ndryshme etj).</p> <p>c) Ndërsa pozitat tjera si: zyrtarja për informim, zyrtari për komunitete menaxheri i projektit dhe asistentet e prokurimit janë të natyrës së veçantë dhe kërkohet komunikim i shpeshtë me qytetar, institucione dhe publikun.</p>	<p>vendim të veçantë për përdorimin e telefonave për pozita të tilla në mënyrë që ne të kemi një normativ tjetër administrativ të krahasimit të shpenzimeve.</p> <p>Të gjeturat dhe rekomandimet qëndrojnë.</p>
<p>Komenti 3 3. Prokurimi</p> <p>Furnizimi me material shpenzues mjekësor për ZPZHML me nr prokurimi: 30900-08-011-136</p> <p>Kuotim çmimesh në vlerë prej 9,895.00€. Nuk janë aplikuar gjordat në vonesën e mallit pasi që ky mall është shumë specifik dhe i tërë materiali porositet vetëm nga shtetet e jashtme, prej njoftimit të parë që ka bërë kompania për vonesën e mallit , Njësia kërkuese ka qenë në dijeni për vonesat e mallit, dhe në pajtim e tyre për pranimin e mallit pjesë-pjesë i cili ka qenë shumë i nevojshëm, ne si AK iu kemi bërë pagesën në bazë të shumës së kontratës. Te bashkangjitura keni , njoftimin e parë me emal, si dhe fletë dërgesat e mallit.</p> <p>Dëshmi: Fletë dërgesat e mallit kur kanë filluar të pranohen.</p>	<p>Afati I liferimit të mallit sipas kontratës ka qenë prej 40 ditëve kalendarike që nga dita e nënshkrimit të kontratës me 30.06.08, ka njoftua 7 ditë vonesë për një pjesë të mallit, ndërsa kontrata është përmbushur me 19.11.2008. Gjordat janë të rregulluara me: <i>5/1000 x pjesa e mbetur e mallit të vonuar x nr i ditëve të vonuara</i> duke mos e kaluar 15% e vlerës së përgjithshme të kontratës.</p> <p>Të gjeturat dhe rekomandimet qëndrojnë.</p>
<p>Furnizim me pajisje dhe material shpenzues mjekësor si dhe servisimi i aparateve mjekësore- me nr prokurimi : 21500-08-031-111.</p> <p>Gjatë përpunimit të kontratës për nënshkrim janë vërejtur gabimet aritmetikore tek OE ne LOT 2 dhe ne LOT 5. Këto gabime aritmetikore janë pranuar nga OE me datën 04.11.2008 me shkresë zyrtare dhe janë pranuar gabimet për LOT 2: nga shuma 49.955.00€ në 54.255.00€ pasi që edhe më tej ka mbetur OE me çmimin me të lirë, si dhe për LOT 5 nga shuma 1.215.00€ në 1.681.00€, po ashtu mbetet OE me çmim me të lirë nga të gjithë OE pjesëmarrës në këtë tender.</p> <p>Dëshmi: Njoftimin mbi korrigjimin e tenderit - llogaritje</p>	<p>Derisa çmimi në hapje është i njëjtë me çmimin e vlerësuar prezantuar nga komisioni dhe me atë të publikuar me 25.10.2008. Sipas raportit të vlerësimit të tenderit nuk ka korrigjime aritmetike nga komisioni vlerësues. Procedurat e prokurimit e parashohin se kontrata duhet të përpilohet në bazë të raportit të vlerësimit nga entiteti. Njoftimin mbi korrigjimin e tenderit –llogaritje bëhet 2 ditë para nënshkrimit të kontratës pa u njoftua fare anëtarët e komisionit apo pa u bërë një rivlerësim paraprak.</p> <p>Të gjeturat dhe rekomandimet qëndrojnë.</p>
<p>Furnizim me Laptop për KM</p> <p>Pasi që kemi pasur kontratë me herët me kompaninë Botek dhe kemi qenë të kënaqur me furnizimin, kjo kërkesë ka qenë kërkesë urgjente dhe është vlerësuar të kemi këtë porosi sa më shpejt të kjo kompani.</p>	<p>Çdo furnizimi duhet të i paraprijë kontrata. Në këtë rast është favorizuar OE Botek.</p> <p>Të gjeturat dhe rekomandimet</p>

	qëndrojnë
<p>Furnizim me bileta aeroplani</p> <p>Shumë herë ndodh që, kërkesat njësit kërkuese i bëjnë përmes telefonit në mënyrë verbale, ndërsa sa i përket zbritjes, kompania ka ofruar zbritje direkt në vlerën totale të ofertës.</p>	Të gjeturat dhe rekomandimet qëndrojnë.
<p>Furnizim me material për elektrik , sanitari dhe moleraj pjesa e 2 me nr prokurimi : 21500-08-099-121</p> <p>1. Kërkesat për iniciimin e procedurave të prokurimit kanë qenë nga Departamentet e Ministrisë së Drejtësisë. Nuk ka pasur mundësi që të hartohet një kërkesë e vetme pasi që çdo departament dhe Njësi e ka kodin e vetë buxhetor dhe zyrtarin e vetë Autorizues. Forma standarde e kërkesës e gjeneruar nga sistemi i Thesarit – zotimi i mjeteve është përdorur si kërkesë për fillimin e procedurave të prokurimit.</p> <p>2. Pasi që është bërë njoftimi për dhënie të kontratës dhe është shpërblyer me kontratë kompania fituese Eltris – Prishtinë , si dhe pasi që kemi pas kërkesë urgjente ne kemi bërë kërkesë te kompania fituese një ditë para se të nënshkruhet kontrata .</p> <p>3. Është e vërtetë se sigurimi i ekzekutimit është vonuar 6 dite – neglizhencë e kompanisë.</p>	<p>1. Asnjë aktivitet i prokurimit nuk guxon të filloi pa kërkesën fillestare të njësive kërkuese.</p> <p>2. Është pranuar se kërkesa për furnizim është bërë një ditë para nënshkrimit të kontratës.</p> <p>3. MD e ka pranuar se sigurimi i ekzekutimit është bërë 6 ditë pas nënshkrimit të kontratës.</p> <p>Të gjeturat dhe rekomandimet qëndrojnë.</p>
<p>Furnizim me material për elektrik , sanitari dhe moleraj pjesa e 1 nr prokurimi : 21500-08-099-121</p> <p>Sigurimi i ekzekutimit të pjesa e parë ekziston, ndërsa kjo kontratë është afatgjatë dhe sasi të vjetore janë të përafërta dhe këto sasi mund të variojnë gjatë tërë vitit sipas kërkesave të njësive kërkuese.</p> <p>Dëshmi: 1. Sigurimi i kontratës</p>	<p>Komenti për sigurimin e ekzekutimit pranohet pasi që është sjellur dëshmia me komente, dhe nuk do të jete pjesë e raportit final.</p> <p>Të gjeturat tjera dhe rekomandimet qëndrojnë.</p>
<p>Furnizimi me pajisje mjekësore laboratorike për ZP. ZHML me numër prokurimi: 21500-08-089-121.</p> <p>Hapja e tenderit është bërë me datën 17.10.2008 për arsye se data 18.10.2008 ka qenë ditë vikendi. OE të eliminuar janë njoftuar përmes telefoni.</p> <p>Dëshmi: 1. Proces Verbal i hapjes 2. Njoftimi në mjetet e informimit</p>	<p>Ky koment i MD pranohet.</p> <p>Kjo e gjetura nuk do të jete pjesë e raportit final.</p>
<p>Marrje me qira e hapësirave për zyre në Prizren me nr prokurimi: 21500-08-100-121.</p> <p>Gjate zhvillimit të procedurës për qira, tre ofertuesit kanë qenë të përgjegjshëm pasi që dy prej tyre kanë qenë objekte të cilat janë privatizuar nga AKPM- ja dhe kanë sjellur dokumentacionin i cili për ne ka qenë i nënkuptueshëm se që të dy ofertuesit e kanë dokumentacionin në rregull pasi që të dy këto objekte dikur ishin objekte – fabrika shtetërore. Ndërsa sa i përket fituesit, fotografitë kanë qenë në CD. Kontrata është e nënshkruar për hapësirën 1300m² me çmim prej 6.3€, dmth totali mujor është 8.190.00€, ku të shfrytëzueshme janë bodrumi, kati përdhës, kati I, Kati II si dhe kati i III i objektit. Kërkesa prej 1000m² në 1300m², është ngritur</p>	<p>Kërkesa e datës 21.10.08' është bërë për 900-1000 m², dosja e tenderit është përgatitur për 1300m², fituesi ka konkuruar me 1600m² me 6.3€/m², kontrata është nënshkruar me 1300m² x 6.3€/m²=8.190€, ndërsa sipas përshkrimit teknik objekti ka sipërfaqen në bruto prej 944.3 m² duke e injoruar operatorin me të lirë prej 900m² x 8.5€/m² = 7.600€.</p> <p>Në dosjen e tenderit si dëshmi e dokumentuar është kërkuar leja e ndërtimit nga komuna, 2 ofertuesit tjerë</p>

<p>sepse në këtë objekt është vendosur edhe SHSK, dhe DMNV.</p> <p>Dëshmi:Dëshmi për foto – CD,</p> <p>Kontrata e nënshkruar me totalin prej 8190 € me 6.30€/m².</p> <p>Njoftimi për lëshim të objektit në Prizren nga SHSK dhe DMNV</p>	<p>nuk e kanë ofruar këtë dokument.</p> <p>Pas sjelljes se CD - foto me komente, komenti për foto pranohet.</p> <p>Të gjeturat dhe rekomandimet tjera qëndrojnë.</p>
<p>Komenti 4Investimet Kapitale</p> <p>1. Ndërtimi i shtallës në Burgun e Dubravës-</p> <p>1. Forma e pagese është bere sipas kësteve të zotimit të mjeteve të përcjellura nga zyra e inxhinieringut .</p> <p>2. Është e vërtete se kemi pasur vonesa në kryerjen e punëve, por ato vonesa nuk janë shkaktuar nga Kontraktorët por vonesat janë shkaktuar për shkak te gjendjes së krijuar në Qendrat e Paraburgimit dhe Burgun e Dubravës. Për shkaqe sigurie shpeshherë është dashur që të ju ndalohet puna kontraktoreve. Të drejtën e aprovimit të vonesave në kryerjen e punëve e kanë pasur projekt menaxheret e projekteve. Ata çdo herë kur kanë pasur arsye, i kanë arsyetuar vonesat.</p> <p>Dëshmi. Zotimi i mjeteve</p>	<p>1Zotimi i mjeteve për investime kapitale afatshkurta duhet të jetë në tërësi para nënshkrimit të kontratës sipas LPP.Nr 2003-17 neni Nr. 8, ndërsa pagesa ashtu si që parashihet me kontratë.</p> <p>2. komenteve nuk iu është bashkangjitur dëshmi mbi arsyeshmërinë e vonesave.</p> <p>Të gjeturat dhe rekomandimet qëndrojnë.</p>
<p>2. Renovimi i Banjave ne QP Prishtine –</p> <p>1. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka propozuar që me kontrate të shpërblehet kompania me çmimin më të lire.</p>	<p>1. Së pari duhet të jenë tre ofertues të përgjegjshëm.</p> <p>Të gjeturat dhe rekomandimet qëndrojnë.</p>
<p>Komenti 5 Paga dhe Mëditje (Personeli):</p> <p>Sipas të gjeturave japim këto sqarime:</p> <p>1. Në kohën e auditimit përshkrimet e vendeve të punëve, janë marrë nga dosjet personale që të rishikohen dhe punohet sistematizimi i ri i vendeve të punës.</p> <p>2. Paga merret në bazë të pozitës që është e paraparë me organogram, e mbështetur me buxhet dhe e aprovuar nga Ministria e Administratës Publike</p> <p>3.Vlerësimet ekzistojnë në përgjithësi, mirëpo, në kohën e auditimit disa prej tyre zyrtaret e personelit nuk kanë arritur ti fajlojnë për shkak të vëllimit të punës dhe numrit të vogël të ekzekutuesve.</p> <p>4.Rasti është i trashëguar nga ish DD/UNMIK , ne nuk kemi autorizime vendimmarrëse, por vetëm mbështetje administrative, edhe tani ende është kompetencë e rezervuar jashtë përgjegjësisë së MD-së. Rasti i përket të punësuarës: Isamete Gosalci , Sekretare Juridike në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, të cilës i është ngritë koeficienti nga 4.5 ne koeficientin 5 ku ekziston vendimin, në dosje të saj personale e datës 15.11.2005.</p>	<p>1. Nuk qëndron ajo arsye, sepse çdo largim i ndonjë dokumenti lënë gjurmë, në këtë rast menjëherë zëvendësohet me tjetrën.</p> <p>2. Edhe ne nuk e kemi mohuar një gjë të tillë.</p> <p>3. Gjatë kohës së auditimit i kemi njoftuar për mungesën e tyre, nuk na i kanë prezantuar.</p> <p>4. Tani nuk jeni kompetencë e rezervuar.</p> <p>Të gjeturat dhe rekomandimet qëndrojnë.</p>